



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	14.04.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Priloz Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3547/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.478/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.478/2023, të datës 09.03.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen administrative-juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 ,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.478/2023 e datës 09.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën 'Zjarrfikës' në Drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim në kuadër të Komunës së Pejës, me datë 13.02.2023, numër protokollit 2537/2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (nënës). Ndërsa me datë 06.03.2023 përmes Vendimit me nr.01-400/01-0621203/2023 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka njoftuar ankuesin se kjo kërkesë refuzohet si e pa bazuar sepse me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik ky kompensim nuk parashihet.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit ,më datë 09.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2537/2023 të regjistruar me numër A.nr.478/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.01-400/01-0621203/2023 të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës. Ndërsa Këshilli me datë 29.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3116/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokolli 2537/2023 të datës 09.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.01-400/01-0621203/2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës; Flet lëshimi me Epikriz nga Spitali Regjional-Pejë e datës 23.11.2022; Flet statistikore për vdekje dem2 e datës 23.11.2022; Afishe me lajmërimin mbi vdekjen; Certifikatë e vdekjes e N.K; Kërkesë për kompensim për anëtarin e ngushtë të familjes me numër protokolli 13775 e datës 13.02.2023; Kartela e bankës e ankuesit; Letërnjoftimi i ankuesit; Ndryshimi i Aktit të emërimit i datës 01.08.2013 i ankuesit; Akt Emërimi i L.K. i datës 04.01.2012; Përgjigjeje me shkrim dhe dërgim i dokumentacionit të kërkuar i datës 24.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi me datë 13.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (Nënës),ndërsa si dëshmi ka ofruar certifikatën e vdekjes me nr.V10569323 të datës 10.02.2023 me të cilin dëshmohet se Nëna i ka vdekur me datë 23.11.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës referuar kërkesës së ankuesit përmes njoftimit Nr.01-400/01-0621203/2023 të datës 06.03.2023 ka njoftuar ankuesin se kjo kërkesë nuk mund të realizohet për shkak të ndryshimit të legjislacionit përkatës që rregullon këtë çështje nga se Ligji i ri Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk parasheh ndonjë lloj page apo kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, i pakënaqur me vendimin/njoftimin e organit të punësimit ,me datë 09.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2537/2023 të regjistruar me numër A.nr.478/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.01-400/01-0621203/2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtue pretendimet ankimore të ankuesit thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: *1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.* Andaj me krijimin e këtyre rrethanave të reja ligjore, kolegji i këshillit konstaton se një e drejtë që ishte e paraparë me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil tashmë të shfuqizuar me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parashihet një kompensim i kësaj natyre me rastin

e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, dhe referuar kësaj baze të re ligjore, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Pejës ka vepruar drejtë me rastin e Vendimit/njoftimit Nr.01-400/01-0621203/2023 të datës 06.03.2023 me që rast ka njoftuar ankuesin se kjo kërkesë nuk mund të realizohet për shkak të ndryshimit të legjislacionit përkatës që rregullon këtë çështje nga se Ligji i ri Nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu me rastin e vendimmarrjes sa i përket kësaj ankese mori për bazë edhe faktin se ankuesi përkundër faktit që Nëna i kishte vdekur më datë 23.11.2022, ankuesi përmes kësaj ankese përkatësisht provave të ofruara nuk ka dëshmuar me asnjë mënyrë dhe formë se i njëjti kishte ndërmarrë veprimet për realizim të kësaj kërkesë brenda afateve ligjore që parasheh legjislacioni përkatës andaj edhe mbi këtë bazë pretendimi në lidhje me kompensimin me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes përkatësisht Nënës është i pabazuar.

Nga ajo që u tha si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.478/2023, datë 14/04/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

